



**Departamenti Hortikulturë dhe  
Arkitekturë Peizazhi**

**f hortidep**

## ***Plani Strategjik***

**2021– 2025**

**Përgjegjësi i Departamentit**

**Prof.Dr. Endrit Kullaj**

Miratuar në mbledhjen e Departamentit të datës 24.06.2021

## Preambula

Departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit (D.HAP) është i vetmi departament në vend që mbulon programe studimi, fusha kërkimit dhe transferim njohurish në hortikulturë, arkitekturë peizazhi dhe kopshtari. Me këtë status, D.HAP synon të plotësojë standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës dhe të jetë promotor i zhvillimit të nën-sektorëve me të cilët lidhet drejtpërdrejt. Në vitin 2016, Departamenti ndërmoi një analizë të pikave të forta, pikave të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve (SWOT). Mbi këtë bazë, D.HAP formuloi një mision dhe vizion të ri dhe trajektorët e programeve të studimit në të ardhmen. Kështu u hap programi Bachelor në Arkitekturë Peizazhi dhe më vonë Programi Profesional i Lartë 2-vjeçar në 'Kopshtari'.

Në vitin 2020, mbështetur në nevojën për leadership dhe ekselencë në mësimdhënie efektive në fushën e hortikulturës, arkitekturës së peizazhit dhe kopshtarisë, rritje të impaktit të kërkimit shkencor dhe angazhimin në ekstension, siç është në traditën e UBT, D.HAP hartoi këtë Plan Strategjik. Korniza konceptuale e përdorur për këtë plan strategjik, përfshin një përshkrim të misionit dhe vizionit të D.HAP, e ndjekur nga artikulimi i objektivave, iniciativave strategjike që lidhen me to, fushave prioritare dhe metrikave për të vlerësuar progresin. Plani Strategjik i D.HAP është i harmonizuar me Strategjinë e UBT dhe Strategjinë e Kërkimit në Shqipëri, që shërbejnë si ombrellë edhe për anëtarët e D.HAP dhe studentët që do të kontribuojnë në përmbushjen e prioriteteve të UBT.

## I. Hyrje

**Hortikultura** është shkencë bujqësore që kontribuon në mënyrë të qenësishme në sigurimin e ushqimit të domosdoshëm për njerëzimin dhe zbukurimin e peizazheve publike e kopshteve familjare, duke krijuar atmosferë e mirëqenie, nëpërmjet kombinimit të energjisë së diellit me tokën, farën, ujin dhe aftësinë krijuese të njeriut. Hortikultura është intensive dhe e sofistikuar. Ajo ka përpunuar teknika të shumëllojshme kultivimi, që ndërsa mundësojnë prodhimin e suksesshëm të perimeve dhe frutave në kushte të ndryshme klimatike dhe tokësore dhe kërcënimesh nga sëmundjet dhe dëmtuesit, plotësojnë kërkesa nga më të ndryshmet të konsumatorëve të shumëllojshëm. Ndërkohë, nëpërmjet një procesi të gjatë seleksionimi, hortikultura ka mundur të krijojë forma bimësh, të afta të përshtaten me mjediset dhe praktika kultivimi nga më të ndryshmet. Ndërsa popullsia e globit rritet pa ndalur, kërkesat për produktet e hortikulturës do të arrijnë në nivele të paimagjinueshme. Për të plotësuar këto kërkesa, hortikultura moderne është tërësisht e kushtëzuar nga përmasat dhe niveli i shfrytëzimit të dijeve të shkencave moderne.

**Arkitektura e peizazhit** është projektimi i mjedisëve të jashtme dhe strukturave për të arritur rezultate mjedisore, sociale ose estetike. Ajo përfshin hulumtimin sistematik të kushteve ekzistuese sociale, ekologjike dhe tokësore dhe proceset në peizazh si dhe projektin ndërhyrje që japin rezultatet e dëshiruara. Objektivi i profesionit përfshin projektimin e peizazhit, planifikimin zonal, kontrollin e erozionit, ripërtëritjen mjedisore, planifikimin e parqeve dhe mjedisëve shlodhëse, menaxhimin e burimeve pamore, planifikimin dhe ofrimin e infrastrukturës së gjelbër, planifikimin e gjelbërimit rezidencial, etj. Interesi kombëtar i vendit në këtë fushë duket edhe në faktin që më 8 Shtator të vitit 2016 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 87/2016 *“Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën europiane të peizazheve”*.

**Kopshtaria** është praktika e kultivimit të bimëve si pjesë e hortikulturës. Nëpërmjet kultivimit të bimëve për ushqim, zbukurim dhe mjekim, kopshtaria kontribuon në krijimin edhe ruajtjen e hapësirave të jashtme me qëllim përmirësimin dhe mbajtjen e një cilësie jete të mirë dhe shëndetëshme, ndërkohë që sigurohet mbijetesa e sistemeve natyrore komplekse, fizike dhe kulturore të cilat përbëjnë planetin tonë. Kopshtaria është një art dhe mjeshtëri e lashtë sa vetë bujqësia dhe i tillë edhe profesioni i kopshtarit. Sot, biznesi i kopshtarisë në Shqipëri, duke përfshirë këtu jo vetëm kërkesën për kopshtarë profesionistë por edhe artikujt e kopshtarisë, përbëjnë një treg të konsiderueshëm.

### **I.1 Misioni**

Departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit (D.HAP) përkushtohet të përgatisë studentë për profesione dhe biznese në hortikulturë dhe arkitekturë peizazhi, të fuqizojë pozitën konkurruese të këtyre sektorëve në Shqipëri dhe të përmirësojë cilësinë dhe sasinë e produkteve hortikulturore dhe përfitimeve nga peizazhi nëpërmjet kërkimit shkencor dhe shërbimeve.

### **I.2 Vizioni**

Ofrimi i mundësive për arsim cilësor në funksion të karrierës në hortikulturë dhe arkitekturë peizazhi, shndërrimin e Departamentit në një qendër dinamike të kërkimit shkencor, referencë në çështjet e hortikulturës dhe arkitekturës së peizazhit si dhe integrimin e kërkimit në nivel evropian.

## **II. Objektivat dhe Inisiativat Strategjike me Përparësi**

### ***Objektivi 1. Nivel i lartë mësimdhënie dhe mësimnxënie inovative***

***Nivel i lartë mësimdhënie dhe mësimnxënie në ciklin e parë dhe të dytë për të përgatitur profesionistë të së ardhmes që do të integrojnë teorinë dhe praktikën në hortikulturë dhe arkitekturë peizazhi, planifikim dhe projektim.***

#### Karakteristikat kryesore

- Përsosmëri në mësimdhënie, duke ofruar njohuri dhe aftësi të përditësuara që studentët t'i nxënë në mënyrë sinergjike duke e integruar me hulumtimin, bursat dhe aktivitete krijuese, si dhe angazhimin në aktivitetet e sektorit publik dhe privat.
- Metoda inovative mësimdhënie dhe mësimnxënie që garantojnë gjerësi dhe thellësi gjithëpërfshirëse të përvojave të të mësuarit për studentët në kurrikulat përkatëse dhe në pikat e forta të D.HAP — ***Intensifikimi i Qëndrueshëm në Hortikulture, Ndërveprimet Bimë Hortikulturore–Mjedis*** si dhe ***Sistemet dhe Projektimi i Peizazhit***.
- Mbështetja e studentëve në të gjitha nivelet e studimit për të arritur potencialin e tyre nepërmjet të menduarit kritik dhe aftësive për të zgjidhur probleme.
- Optimizimi i ofrimit të mësimdhënies brenda dhe jashtë auditorit, përfshi edukimin dixhital.
- Udhëheqje dhe këshillim i përkushtuar ndaj studenteve për të garantuar suksesin e procesit edukativ dhe zhvillimit të karrierës
- Ekspozimi i studentëve ndaj formave të larmishme të mësimnxënies siç është fitimi i përvojës, jashtë–kurrikulare dhe ndër–kurrikulare.
- Zvogëlimi i hendekut teori-praktikë në formimin e studentëve për të lehtësuar përfshirjen e tyre në tregun e punës.
- Shanse më të larta për një ndërlidhje më të mirë të programeve të studimit me nevojat e shoqërisë, ekonomisë dhe kërkesat e tregut të punës.

#### Inisiativa Strategjike

- Zhvillimi dhe zbatimi i ideve inovative në metodat e mësimdhënies në pikat e forta të D.HAP për të zëvendësuar metodat e vjetruara të mësimdhënies që fokusohen në memorizim dhe riprodhimin e fakteve, duke neglizhuar nevojën për aftësimin e studentëve që të nxënë gjatë gjithë jetës dhe të zgjidhin probleme komplekse nga fusha e tyre e specializimit.
- Theks më të lartë mësimdhënies cilësore, të mësuarit me në qendër studentin dhe përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies.
- Zbatimi i ideve inovative në disiplinat karakterizuese, përfshi mësimnxënien e mbështetur tek eksperiencat, bashkëpunimi, edukimi dixhital, të cilat ndërtohen mbi njohuritë se si studentët nxënë me qëllim që të avancojnë mësimdhënies dhe mësimnxënien në të gjitha nivelet.

- Auditorë dhe mjedise të tjera të mësimdhënies me standarde në përputhje me cilësinë e pritshme të përvojave të mësimnxënies për përmirësimin e konkurrueshmërisë me institucione homologe.
- Zgjerimi dhe përmirësimi i Studios së Arkitekturës së Peizazhit në përputhje me standardet më të larta të ekselencës dhe të akreditimit.
- Krijimi i ambjenteve për ndërveprimin informal ndërmjet personelit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve për të nxitur shkëmbimin e njohurive dhe orvatjeve ndërdisiplinare/bashkëpunuese në mësimdhënie dhe mësimnxënie.
- Rishikimi i kurrikulave dhe programeve të studimit për të përmirësuar konkurrueshmërinë me institucione homologe dhe regjistrimin e studentëve.
- Kërkimi për burime financiare shtesë (p.sh., nga donatorë që mbështesin arsimin, fondacioneve të huaja dhe agjensive publike për të intensifikuar më tej përvojat e mësimnxënies së studentëve, përfshi programet e shkëmbimit dhe internshipe.
- Organizimi i praktikave të studentëve nëpërmjet marrëveshjeve të formalizuara me institucionet publike, agjencitë, bizneset dhe kompanitë private, si dhe zhvillimi i më shumë programeve ndërdisiplinore të studimit.
- Rritja e edukimit dixhital në mbështetje të zhvillimit të kurseve on-line për një klientelë të gjerë.

## ***Objektivi 2. Rritja dhe diversifikimi i regjistrimeve në programet e ciklit të parë dhe të dytë***

***Interes i shtuar i maturantëve për të ndjekur një karrierë në biznese të hortikulturës dhe arkitekturës së peizazhit si edhe në kërkim shkencor dhe këshillim.***

### Karakteristikat kryesore

- D.HAP ka një plan promovimi të programeve të studimit për të zgjuar interesin e maturantëve.
- Krijimi i lidhjeve formale me institucionet e arsimit të mesëm, mësues të lëndëve që lidhen me shkencat bimore dhe informimi i nxënësve për hortikulturën dhe arkitekturën e peizazhit.
- Organet drejtuese të UBT janë të ndërgjegjësuar për nevojën dhe cilësinë e rekrutimit të asistentëve të talentuar në disiplina karakterizuese të D.HAP.
- Tërheqja e opinioneve dhe rekomandimeve të studentëve të diplomuar në ciklin e parë lidhur me përmirësimin e programeve të studimit, krijimi i një databaze për ndjekjen e tyre, përfshi punësimin
- Rritja e mundësive për punë praktike në studimet e larta.

- Krijimi i Bordit të Këshillimit dhe Mbështetjes së D.HAP me biznese dhe ente publike në fushën e hortikulturës dhe arkitekturës së peizazhit.
- Sigurimi i integritetit akademik, transparencës dhe llogaridhënies në sektorin e arsimit të lartë.
- Përmirësimi i statusit socio-ekonomik të studentëve nëpërmjet ofrimit të shërbimeve cilësore dhe formave të ndryshme të ndihmës financiare.
- Plani i investimeve prioritare në infrastrukturën didaktike dhe kërkimore të D.HAP dhe ndërmarrrja e fushatave për sigurimin e mbështetjes financiare ose në natyrë.

### Inisiativa Strategjike

- Rritja e vizibilitetit të D.HAP dhe programeve të studimit që ofron.
- Përfshirja e studentëve dhe alumni në orvatjet për rritjen e regjistrimeve në programin Hortikulturë.
- Rritja e ngarkesës së mësimi në disiplina me rëndësi për sektorin siç është perimtaria, pemëtaria, vreshtaria, ullishtaria, mjediset e mbrojtura, etj. në programet e studimit jashtë D.HAP.
- Hartimi i një plani dhe sigurimi i mbështetjes për përmirësimin e ambjenteve të mësimi dhe praktikës.
- Hartimi i një strategjie dhe plani për të përfshirë hortikulturën në aktivitetet brenda-shkollore dhe jashtë-shkollore anembanë vendit.
- Mbështetje për studentët në momentet kritike në jetën e tyre studentore, duke ju ofruar një sërë përfitimesh si këshillim, përfshirje në praktika të ndryshme kërkimore dhe profesionale, rrjetëzim me profesionistë të tjerë, zhvillimin e aftësive të transferueshme që do t'i ndihmojë ata gjatë kohës së studimeve dhe më gjerë.
- Mentorimi i studentëve gjatë jetës studentore për t'u mundësuar atyre të eksplorojnë rrugët e karrierës në mjediset e botës reale.
- 

### **Objektivi 3. Fuqizimi i programeve të studimit**

***Rritja e cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet modernizimit të infrastrukturës akademike, aplikimit të standardeve të larta të vlerësimit të programeve të studimit dhe përshtatja e kurrikulave me shpejtësinë e ndryshimeve socio-ekonomike dhe zhvillimeve të tregut.***

## Karakteristikat kryesore

- Përmirësimi i kurrikulës në funksion të kërkesave të tregut të punës dhe ndryshimeve socio-ekonomike
- Përmirësimet në infrastrukturën akademike si godina, pajisje, kabinete, laboratorë e biblioteka që janë në shërbim të personelit akademik dhe të studentëve të D.HAP.
- D.HAP diplomon studentë me njohuri dhe aftësi të theksuara teknike e profesionale jo vetëm në hortikulturë dhe arkitekturë peizazhi por edhe aftësi transversale që përfshijnë një sërë aftësish që nevojiten për të kryer detyra në një shumëllojshmëri mjedisesh të vendit të punës.
- Aftësimi i studentëve për t'iu përshtatur ndryshimeve të kërkesave brenda një pune ose lëvizjen lehtësisht nga një punë ose rol në tjetrin gjatë karrierës së tyre, ndërsa tregu i punës evoluon.
- Akreditimi i MSc Hortikulturë dhe MP Teknologji të Avancuara në Hortikulturë
- Ofrimi i programeve të studimit që përputhen me fushat e kompetencave të D.HAP.
- Promovimi i programeve tek punëdhënësit dhe studentët potencialë
- Krijimi i Shoqatës së Studentëve të Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit me pjesëmarrjen e disa lektorëve në rolin e këshilltarëve
- Lehtësimi i funksioneve sociale dhe përvojave të mësimnxënies për studentët
- Rritja e mundësive për bursa, programe shkëmbimi, mbështetja e studentëve për të përgatitur aplikime
- Avancimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe shërbimeve digjitale dhe ofrimi i kompetencave digjitale për t'iu përgatitur të rinjtë mjaftueshëm për sfidat dhe mundësitë e një ekonomie të globalizuar.

## Inisiativa Strategjike

- Miratimi i një politike për zhvillimin e kurrikulave me synimin për t'iu bazuar ato në kompetenca ose rezultate të nxënies, si dhe për t'iu orientuar të rinjtë sa më mirë drejt tregut të punës në hortikulturë dhe arkitekturë peizazhi.
- Hartimi i kurrikulave që i përgjigjen kontekstit të ekonomive të sotme të globalizuara, të drejtuara nga inovacioni dhe të bazuara në aftësi.
- Organizimi i takimeve të shpeshta për biznese të hortikulturës dhe arkitekturës së peizazhit që promovojnë produktet, shërbimet dhe mundësitë për karrierë tek studentët.
- Krijimi i një fryme komuniteti dhe forcimi të ndëveprimit ndërmjet studentëve të hortikulturës dhe arkitekturës së peizazhit nga të gjithë ciklet e studimit.
- Krijimi i programeve të studimit të përbashkëta me IAL-të evropiane dhe në gjuhën angleze

- Organizimi i ditëve të hapura ku maturantët të njohin mjedise të mësimit në hortikulturë dhe arkitekturë peizazhi
- Shfrytëzimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për akses në materiale mësimore cilësore, përmirësimin e shërbimeve të tjera për studentët siç janë ato të sekretarisë.

***Objektivi 4. Dokumentimi dhe promovimi i vlerës publike të transferimit të njohurive në Hortikulturë dhe Arkitekturë Peizazhi si dhe përmirësimi i shoqërisë përmes angazhimit efektiv***

***Demonstrimi i ekselencës në angazhimin universitar që i shërben aktivitetit akademik, sektorit, qeverisë qendrore dhe vendore, si dhe shoqërisë në përgjithësi.***

**Karakteristikat kryesore**

- Lidhship i demonstruar në krijimin dhe ofrimin e programeve dhe produkteve të ekstensionit cilësore të mbështetur në kërkim shkencor, në pritshmërinë e nevojave të sektorit, të UBT, për të tërhequr vëmendjen, interesin dhe njohjen brenda dhe jashtë vendit.
- Kontribut për të mirën publike përmes komunikimit dhe dialogut efektiv me aktorët dhe faktorët që udhëheqin drejtimet e kërkimit të zbatuar dhe programeve arsimore mbi çështje prioritare.
- Partneritet me përfitime reciproke në lidhje me sektorin, publikun dhe grupet e interesit për të lehtësuar lidhshipin dhe zgjidhjen e problemeve.
- Përhapje e shënjestruar e informacionit shkencor të rëndësishëm për informimin në funksion të politikave të zhvillimit të nën–sektorëve të bujqësisë.
- Promovimi i arritjeve të D.HAP në nivelin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar me synim forcimin e lidhjeve të alumni dhe për sigurimin e fondeve nga biznese private.

**Inisiativa Strategjike**

- Botimi i artikujve me natyrë divulgative nëpërmjet portalit UBGreen
- Zbatimi i teknologjive të reja për të përmirësuar ofrimin e programeve të ekstensionit.
- Zhvillimi dhe vënia në dispozicion e burimeve për të rritur financimin e programeve të kërkimit dhe transferimit të njohurive në fermë.
- Analizimi i prirjeve në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar për të përcaktuar tematikat më aktuale dhe identifikuar çështje kritike në lidhje me sektorin e hortikulturës



- Ofrimi i më shumë opsioneve të mbështetura tek interneti dhe të asinkronizuara për trajnimin e ekstensionistëve për tematika të caktuara.
- Promovimi i përfshirjes së studentëve të hortikulturës në programet e ekstensionit.
- Fuqizimi i sinergjive akademike, duke theksuar lidhjet ndërmjet mësimdhënies, hulumtimit dhe transferimit të njohurive, si një shenjë dalluese e programeve të shërbimit këshillimor.
- Hartimi dhe zbatimit i planeve të dokumentuara për rezultatet e programit për transferimin e njohurive në hortikulturë.
- Hartimi i një programi të transferimit të njohurive për të mbështetur ekstensionistët publikë dhe këshilluesit privat.
- Përmirësimi i komunikimeve me ekstensionistët dhe këshillues për të rritur mundësitë e trajnimeve.
- Zhvillimi i hapsirës/ambjenteve të ndërveprimit informal për personelin akademik dhe studentët për të nxitur shkëmbimin e njohurive dhe orvatjet ndërdisiplinare/bashkëpunuese në iniciativat e ekstensionit.
- Fuqizimi i angazhimit të alumni dhe aktivitete për sigurimin e fondeve për të promovuar arritjet e D.HAP dhe lidhja programore të alumni me personelin akademik dhe studentët.